

1 E diel, 8 dhjetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Paraqitja e parë]

4 [I akuzuari Smakaj hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 10.45

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Mirëmëngjes dhe mirë se
7 keni ardhur të gjithë në këtë seancë të Paraqitjes së Parë.

8 Znj. Sekretare e seancë ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, e nderuar
10 Gjykatëse, kjo është çështja KSC-BC-2023-12, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni
12 Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit.

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, znj.
14 Sekretare.

15 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Përpara sesa të fillojmë
16 dëshiroj t'i jap mundësinë fotografes që të bëjë disa
17 fotografi.

18 Znj, Fotografe, mund të vazhdoni me fotografitë.

19 Mesa kam kuptuar z. Smakaj nuk dëshiron që të paraqitet
20 në fotografi ngjitur me rojet e sigurisë, kështu që do ju
21 udhëzoja që të bënit fotografi vetëm nga afër të z. Smakaj.

22 Mund të vazhdoni.

23 Faleminderit, znj. Fotografe.

24 Përpara sesa t'u kërkoj palëve që janë të pranishëm në
25 sallë që të prezantohen, dua që t'ju kujtoj të gjithëve për

1 rregullat që duhet të respektohen gjatë të gjithë kohës, në
2 mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja e procedurave.

3 Ju lutem sigurohuni që keni ndezur mikrofonin përpara
4 sesa të flisni dhe që ta fikni mikrofonin sapo të keni
5 përfunduar së foluri. Flisni ngadalë dhe qartë sepse e gjithë
6 seanca përkthehet nga shqipja në anglisht dhe nga anglishtja
7 në shqip dhe në serbisht. Po ashtu, bëni një pauzë prej pesë
8 sekondash përpara se t'i jepni përgjigje pyetjeve që do t'ju
9 bëj unë ose një palë tjetër për hir të përkthyesve.

10 Dua t'ju kujtohet gjithashtu që informacioni i caktuar në
11 këtë lëndën gjyqësore i nënshtrohet rregullave të
12 konfidencialitetit. Informacioni konfidencial nuk do të
13 nxirret në seancë të hapur. Në qoftë se ndonjëra nga palët
14 dëshiron që të përmendi informacion konfidencial ose të
15 diskutojë një informacion të tillë ju lutem na kërkoni që të
16 kalojmë në seancë private.

17 Tani do ju kërkoja palëve që të prezantohen duke filluar
18 nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

19 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës,
20 unë jam Prokurori nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Quhem
21 Joshua Hafetz, së bashku me mua është edhe Prokuroria Kim West
22 dhe gjithashtu janë edhe Gaia Pergolo, Earl Sullivan nga ZPS-
23 ja.

24 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Tani nga Mbrojtja.

25 Z. MARTENS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës,

1 unë quhem Bas Martens, dhe jam avokat i z. Smakaj.

2 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

3 Për procesverbal z. Smakaj vërej që është i pranishëm në
4 sallën e gjyqit. Tani do t'i drejtohem Zyrës Administrative.

5 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.
6 Kolegë, mirëmëngjes. Unë quhem Nilsson, jam Jonas Nilsson dhe
7 jam Zëvendësadministratori. Jam së bashku këtu me Whitney
8 Price, që është eksperte ligjore.

9 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Për procesverbal unë jam
10 Majorie Masselot, që jam Gjykatësja e Procedurës Paraprake për
11 këtë lëndë gjyqësore.

12 I akuzuari paraqitet për herë të parë sot përpara Dhomave
13 të Specializuara pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij me
14 datë 29 nëntor 2024.

15 Z. Smakaj, a mund të ngriheni në këmbë, ju lutem?

16 A mund ta ndizni mikrofonin?

17 Na thoni si quheni, emri dhe mbiemri i plotë.

18 I AKUZUARI SMAKAJ: Bashkim Smakaj.

19 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Cila është vendlindja dhe
20 datëlindja juaj?

21 I AKUZUARI SMAKAJ: Vendlindja është Klinë, fshati Këpuz,
22 datëlindja është 01.07.1976.

23 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Çfarë shtetësie keni ose
24 në qoftë se keni më shumë se një shtetësi, çfarë shtetësish
25 keni?

1 I AKUZUARI SMAKAJ: Shtetësinë e Kosovës dhe shtetësinë e
2 Shqipërisë.

3 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Çfarë profesioni keni
4 aktualisht?

5 I AKUZUARI SMAKAJ: Pjesërisht i angazhuar si profesor në
6 një universitet në Prishtinë.

7 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Z. Smakaj, përpara se të
8 vijojmë më tej, më duhet që të sigurohem që ju e ndiqni
9 procesin gjyqësor në një gjuhë që ju e kuptoni dhe e flisni. A
10 mund të konfirmoni, ju lutem, që e kuptoni dhe e flisni
11 shqipen?

12 I AKUZUARI SMAKAJ: Po.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
14 z. Smakaj. Përmes kësaj unë jam e bindur që ju mund të ndiqni
15 procesin gjyqësor në shqip, një gjuhë që ju e kuptoni dhe e
16 flisni në pajtim me rregullën 92 të Rregullores së Procedurës
17 dhe Provave.

18 Nëse në çdo moment gjatë këtij procesi gjyqësor nuk e
19 merrni përkthim, ju lutem, ma vini përnjëherë në dijeni këtë
20 gjë.

21 Tani mund të uleni z. Smakaj. Dhe fikenë mikrofonin po
22 ashtu.

23 Tani do të paraqes një historik të shkurtër procedural
24 për të prezantuar paraqitjen e parë të z. Smakaj sot.

25 Me datë 29 nëntor 2024, në cilësinë time si Gjykatëse e

1 Procedurës Paraprake, unë kam konfirmuar pjesërisht aktakuzën
2 e dorëzuar nga Prokurori i Specializuar kundër zotërinjve
3 Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Isni Kilaj, Fadil Fazliu dhe
4 Hajredin Kuçi, që e akuzojnë z. Smakaj me një pikë për
5 përpjekje për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e
6 detyrave zyrtare përmes pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët
7 të një grupi; dhe një pikë për kundërshtim të Gjykatës, për
8 mosbindje ndaj Gjykatës.

9 Po ashtu kam lëshuar një fletë-arresti për z. Smakaj të
10 njëjtën datë.

11 Me datë 5 dhjetor 2024, ZPS-ja e arrestoi z. Smakaj në
12 Kosovë dhe atij i është dhënë një kopje e fletë-arrestit,
13 Aktakuza e Konfirmuar dhe vendimin për fletë-arrestin e vet të
14 përkthyer në shqip.

15 Më 6 dhjetor 2024, z. Smakaj është transferuar në njësinë
16 e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë.
17 Të njëjtën datë unë kam nxjerrë një vendim që përcakton datën
18 e sotme si datën për seancën e Paraqitjes së Parë.

19 Tani më lejoni që t'ju kujtoj se cili është qëllimi
20 konkret i Paraqitjes së Parë për z. Smakaj.

21 Z. Smakaj, seanca e ditës së sotme nuk është proces
22 gjyqësor, nuk është gjyq. Në të nuk do të paraqiten prova dhe
23 nuk do të debatohen këto prova si dhe nuk do të diskutohet ose
24 nuk do të vendoset për fajësinë ose pafajësinë tuaj.

25 Qëllimi i kësaj Paraqitje të Parë parashikohet në nenin

1 39(5) i Ligjit, dhe rregullën 92 të Rregullores. Sipas këtyre
2 këto dispozitave, si Gjykatësi i Procedurës Paraprake unë:

3 Do t'ju lexoj akuzat në Aktakuzën e Konfirmuar;

4 Do të konfirmoj që i akuzuari e kupton aktakuzën;

5 Do bindem që të drejtat e të akzuarit, në veçanti, e
6 drejta e tij për mbrojtje ose për avokat mbrojtës janë të
7 respektuara;

8 Dhe do të informoj të akzuarin se brenda 30 ditë nga
9 dita e sotme ai do kërkohet që të vetëdeklarojë sa i takon
10 fajësisë ose pafajësinë për secilën nga akuzat e paraqitura në
11 aktakuzë. Në qoftë se i akuzuari dëshiron ta bëjë këtë gjë, ai
12 menjëherë gjithashtu mund të vetëdeklarohet sa i takon
13 fajësisë ose pafajësisë së tij.

14 Dhe së fundi, unë do caktoj data të tjera të nevojshme
15 për ushtruar funksionet e mia si Gjykatëse e Procedurës
16 Paraprake.

17 Këto janë çështje që do t'i trajtoj sot sa i takon
18 Paraqitjes së Parë tuajës. Në qoftë se ndonjëra nga palët
19 dëshiron që të diskutojë ndonjë çështje tjetër që nuk është e
20 parashikuar shprehimisht në kontekstin e kësaj thirrje ose
21 Paraqitje të Parë, unë ju ftoj që ta bëni këtë përmes një
22 parashtrimi të protokolluar në formë të shkruar.

23 Z. Smakaj, së pari, do ju ftoja të ngriheshit në këmbë.

24 Ju lutem ndizeni mikrofonin.

25 Do ju kërkoja që të konfirmoni që keni marrë një kopje të

1 Aktakuzës së Konfirmuar në një gjuhë që ju e kuptoni dhe e
2 flisni. A e konfirmoni këtë z. Smakaj?

3 I AKUZUARI SMAKAJ: Po, e konfirmoj.

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Smakaj.

5 Përpara se Sekretarja e seancë të lexojë aktakuzat e
6 konfirmuara kundër jush, dëshiroj t'ju kujtoj që kjo nuk është
7 koha që të kundërshtoni akuzat, por thjesht të thënë që i
8 kuptuat akuzat. Do të keni mundësi që të kundërshtoni akuzat
9 me ndihmën e avokatit tuaj.

10 Tani do t'i kërkoj znj. Sekretare të seancës që të lexojë
11 akuzat në Aktakuzën e Konfirmuar sikurse parashikohet në nenin
12 39(5) të Ligjit dhe rregullën 92(2)(b) e Rregullores.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
14 Gjykatëse.

15 1. Në Aktakuzën e Konfirmuar Prokurorja e Specializuar e
16 akuzon Bashkim Smakajn për:

17 Pika 12: Tentative për pengim të personave zyrtarë,
18 veçanërisht prokurorë dhe hetuesit e ZPS-së në kryerjen e
19 detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në një veprim të
20 përbashkët të një grupi, e ndëshkueshme në bazë të nenit
21 401(2) dhe (5) i Kodit Penal të Kosovë të vitit 2019 dhe nenit
22 15(2) të Ligjit; dhe

23 Pikat 13: Mosbindje ndaj Gjykatës, e ndëshkueshme në bazë
24 të nenit 393 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019 dhe nenit
25 15(2) të Ligjit.

1 2. Këto vepra penale u kryen midis të paktën 9 shtatorit
2 dhe 30 tetorit 2023.

3 3. Në lidhje me këto vepra penale ekziston dyshimi i
4 bazuar mirë se z. Bashkim Smakaj mban përgjegjësi penale në
5 bazë të nenit 16(3) të Ligjit për:

6 a. Kryerjen të veprës penale të tentativës së pengimit të
7 personave zhytarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas Pikës
8 12, në bazë të nenit 17 të Kodit Penal të Kosovë të vitit
9 2019.

10 b. Ndihmë dhënë për z. Hashim Thaçi në kontekst të grupit
11 në kryerjen veprës penale të tentativës së pengimit të
12 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas Pikës
13 12, në bazë të nenit 33 të Kodit Penal të Kosovës të vitit
14 2019.

15 c. Ndihmë dhënë z. Hashim Thaçi në kryerjen e veprës
16 penale për mosbindje ndaj Gjykatës sipas Pikës 13, në bazë të
17 nenit 33 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019; dhe

18 d. Marrëveshje për kryerjen me z. Hashim Thaçi në
19 kontekst të grupit në kryerjen e veprës penale të tentativës
20 së pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave
21 zyrtare sipas Pikës 12, në bazë të nenit 35 të Kodit Penal të
22 Kosovës të vitit 2010.

23 Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

24 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, znj.

25 Sekretare.

1 Z. Smakaj, a i kuptuat aktakuzat e ngritura kundër jush
2 dhe që përmbahen në Aktakuzën e Konfirmuar sikurse u lexuan
3 për ju nga znj. Sekretare e seancës?

4 I AKUZUARI SMAKAJ: Po, i kuptova.

5 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Smakaj.
6 Mund të uleni.

7 Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja e
8 Dhomave të Specializuara ju garanton disa të drejta. Do lexoj
9 për juve ato që janë më të rëndësishme. Në veçanti ato të
10 cilat janë të rëndësishme për këtë pikë të procedurës.

11 Ju prezumoheni i pafajshëm derisa të provoheni fajtor
12 përtej dyshimit të arsyeshëm.

13 Në vërtetimin e akuzave të ngritura kundër jush, ju keni
14 të drejtë që t'i nënshtroheni seancave të drejta dhe publike,
15 në varësi të masave të urdhëruara për mbrojtjen e viktimave
16 dhe dëshmitarëve.

17 Keni të drejtën të informoheni menjëherë dhe në hollësi,
18 në një gjuhë që ju e kuptoni, lidhur me natyrën dhe shkakun e
19 akuzave të ngritura ndaj jush.

20 Keni të drejtë për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme
21 për përgatitjen e Mbrojtjes tuaj dhe për të komunikuar me
22 avokatin e zgjedhur prej jush.

23 Keni të drejtën që të gjykoheni brenda një kohe të
24 arsyeshme.

25 Keni të drejtën të gjykoheni në praninë tuaj dhe të

1 mbroheni përmes avokatit.

2 Keni të drejtën që t'ju caktohet një avokat pa pagesë në
3 qoftë se nuk keni mjete të mjaftueshme për të paguar për
4 avokatin.

5 Keni të drejtën që të merrni ndihmë pa pagesë të një
6 përkthyesi në qoftë se nuk e kuptoni ose nuk e flisni gjuhën
7 që përdoret në Gjykatë.

8 Keni të drejtën që të mos detyroheni që të deklaroheni
9 kundër vetes ose që të pranoni fajësinë.

10 Keni të drejtën që të mos flisni dhe në një rast të tillë
11 nuk do të ketë pasoja negative që rrjedhin ose që burojnë prej
12 mosfoljes tuaj.

13 Keni gjithashtu të drejtën që të mos mbaheni të ndaluar
14 për një periudhë të paarsyeshme përpara hapjes së çështjen, të
15 kërkoni rishikim të vendimeve për ndalimin tuaj dhe që t'i
16 apeloni këto vendime drejtpërsëdrejti përpara Gjykatës së
17 Apelit.

18 Z. Smakaj, sikurse e thashë dhe më lart, ju kam lexuar të
19 drejtat më të rëndësishme që ju gëzoni në pajtim me kuadrin
20 ligjor të zbatueshëm të Dhomave të Specializuar.

21 A i kuptoni këto të drejtat, z. Smakaj?

22 I AKUZUARI SMAKAJ: Po, i kuptoj.

23 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Smakaj.

24 Po ashtu dëshiroj t'ju informoj se në pajtim me nenin

25 21(5) i Ligjit, ju nuk mund ta përfaqësoni veten sepse

1 aktualisht jeni në paraburgim. Përfaqësimi nga Mbrojtësi i
2 Specializuar është i detyrueshëm.

3 Vërej për procesverbal që ju jeni i përfaqësuar nga
4 avokati Martens. Për rrjedhojë unë jam e bindur që i akuzuari
5 aktualisht është i përfaqësuar nga një avokat mbrojtës.

6 Tani do kaloj tek e drejta e të akuzuarit për t'u
7 vetëdeklaruar për fajësinë apo pafajësinë e tij, në pajtim me
8 rregullin 92 të Rregullores.

9 Z. Smakaj, sikurse e përmenda dhe më herët, brenda 30
10 ditësh nga dita e sotme do t'ju kërkohet që ju të
11 vetëdeklaroheni lidhur me fajësinë ose pafajësinë tuaj për
12 akuzat në aktakuzë. Në qoftë se vendosni ta bëni këtë, mund të
13 deklaroheni menjëherë lidhur me fajësisë ose pafajësisë tuaj.
14 Për rrjedhojë, dua t'ju pyes tani, z. Smakaj, në qoftë se keni
15 pasur mundësi që të diskutoni për akuzat në Aktakuzën e
16 Konfirmuar me avokatin tuaj, dhe në qoftë se jeni të
17 përgatitur që të vetëdeklaroheni tani në këtë kohë, tani pra.

18 I AKUZUARI SMAKAJ: A mund të konsultohem me avokatin?

19 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Po, patjetër. Avokat,
20 dëshironi që të bëjmë një pushim.

21 Në rregull, atëherë. Do bëjmë pushim për 10 minuta në
22 qoftë se 10 minuta ju mjaftojnë. Ora është 11.00. Do mblidhemi
23 përsëri në orën 11.10.

24 --- Seanca ndërpritet në orën 11.02

25 --- Seanca rifillon në orën 11.10

1 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Jemi sërish në seancë.

2 Për procesverbal vërej se të gjitha palët dhe përfaqësuesit e
3 Zyrës Administrative janë të pranishëm në sallën e gjyqit.

4 Z. Smakaj, përpara pushimit që kërkuat ju, në mënyrë që
5 të konsultoheshit me avokatin tuaj, unë ju bëra një pyetje dhe
6 pyetja ime ishte: A patët mundësi të diskutonit akuzat në
7 Aktakuzën e Konfirmuar me Avokatin tuaj dhe nëse jeni i
8 përgatitur të vetëdeklaroheni aktualisht në sallën e gjyqit
9 lidhur me fajësinë apo pafajësinë tuaj? Cila është përgjigja
10 juaj, z. Smakaj?

11 I AKUZUARI SMAKAJ: Gjatë takimit që kemi pas dje,
12 materialet të cilat i kam pranuar i kemi shqyrtuar, por pas
13 konsultimit që pata tani, vendos që të shfrytëzoj periudhën
14 kohore prej 30 ditëve, që të marr edhe materialet shtesë të
15 shof pasi nuk i kam të gjitha materialet e nevojshme për të
16 dhënë deklarimin sot.

17 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

18 Po e marr parasysh që z. Smakaj nuk është vetëdeklaruar
19 aktualisht, do t'u kërkoja palëve të japin pikëpamjet e tyre
20 paraprake, në qoftë se kanë, sa i takon një seance tjetër, ku
21 do të diskutohet fajësia apo pafajësia.

22 Vërej se kjo seancë duhet të mbajtur brenda 30 ditësh nga
23 dita e sotme, që i takon data 7 janar 2025, që është një datë
24 që i takon në të njëjtën periudhë që ka dhe pushimet Gjykata.

25 Ka diçka për të thënë Mbrojtja e z. Smakaj lidhur me

1 këtë? Z. Avokat, fjala është për ju.

2 Z. MARTENS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë do të
3 doja të thoja dhe diçka për paraburgimin e klientit tim sot.

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Lidhur me paraburgimin
5 mund të shpreheni pak më vonë ju lutem.

6 Z. MARTENS: [Përkthim] Sa i takon konferencës së javës së
7 ardhshme dhe seancës që ju sapo përmendët, nëse është e
8 mundshme, ju lutem të keni parasysh edhe planifikimin tim,
9 data 7 janar është po ashtu pushim për mua, jam në periudhë
10 pushimesh, pra, nëse është e mundur ta bëjmë këtë seancë
11 përpara Krishtlindjeve.

12 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, Avokat. Kjo
13 është zbardhur tashmë në procesverbal.

14 Prokurori i Specializuar?

15 Z. HAFETZ: [Përkthim] Ne jemi të gatshëm në çdo moment
16 për të pasur këtë seancë.

17 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Merret parasysh edhe kjo.
18 Faleminderit.

19 Seanca për vetëdeklarimin do të planifikohet brenda
20 afateve.

21 Tani të flasim për gjuhën që do të përdoret gjatë këtij
22 procesi gjyqësor.

23 Në vendimin ku caktova dhe seancën e sotme, u kërkova
24 palëve të bënin parashtrime me gojë sa i takon gjuhës që do të
25 përdoret në këtë lëndë gjyqësore, sipas rregullës 8 të

1 Rregullores.

2 Ju lutem palëve të shprehin parapëlqimin e tyre.

3 Fillojmë me Prokurorin e Specializuar.

4 Z. HAFETZ: [Përkthim] Anglishtja, ju lutem.

5 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Merret parasysh.

6 Mbrojtja?

7 Z. MARTENS: [Përkthim] E kam diskutuar me klientin tim

8 edhe ne zgjedhim anglishten.

9 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Merret parasysh.

10 Faleminderit. Do të nxjerrë vendimin përkatës brenda afateve.

11 Në vendimin ku caktova seancën e sotshme, po ashtu bëra
12 me dije se synoj që të mbajmë konferencën e parë mbi ecurinë e
13 çështjes, në bazë të rregullës 96 të Rregullores, për të
14 martën 17 dhjetor 2024 në orën 2.00 të pasdites. Dhe lidhur me
15 këtë kërkoj të bëni parashtrime me gojë sot nëse Avokati
16 dhe/ose i akuzuari synojnë të marrin pjesë në konferencën mbi
17 ecurinë e çështjes gjyqësore personalisht apo përmes
18 videolidhjes.

19 Z. Avokat, fjala është për ju.

20 Z. MARTENS: [Përkthim] Faleminderit. Unë synoj të jem i
21 pranishëm fizikisht.

22 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Po klienti, e keni
23 diskutuar këtë me klientin tuaj?

24 Z. MARTENS: [Përkthim] Edhe klienti do të jetë i
25 pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit.

1 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Merret parasysht.

2 Faleminderit.

3 Tani i drejtohem Prokurorisë. Po Prokuroria?

4 Z. HAFETZ: [Përkthim] Do të jemi të pranishëm fizikisht.

5 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

6 Do nxjerrë urdhrin përkatës brenda afateve dhe aty do të
7 jetë dhe rendi i ditës. Në urdhrin për seancën në fjalë, do të
8 jap dhe udhëzime sa u takon detyrimeve që duhen respektuar për
9 të marrë pjesë në konferencën mbi ecurinë e çështjes gjyqësore
10 përmes videolidhjes në qoftë se do të ketë ndonjë ndryshim.

11 Tani do të flas tek pika tjetër në rendin e ditës për
12 sot, që lidhet me paraburgimin, z. Avokat. Lidhur me
13 paraburgimin e z. Smakaj, rikujtoj se bazuar në konstatimin se
14 ekziston dyshimi i bazuar se keni kryer veprat penale që sapo
15 ua lexuam, është lëshuar një fletë-arrestim kundër jush më 29
16 nëntor 2024. Në bazë të nenit 41(6)(b) të Ligjit, arrestimi
17 juaj u gjykua i domosdoshëm bazuar në ekzistencën e arsyeve të
18 besueshme se ju jeni një person që jeni në rrezik arratisjeje
19 dhe mund të pengoni ecurinë e procesit gjyqësor, si dhe mund
20 të përsërisni veprat penale në fjalë.

21 Gjithashtu rikujtoj se kur u arrestuat, morët dhe
22 vendimin që kam lëshuar unë mbi kërkesën për fletë-arrestim
23 dhe çështje në lidhje me të, i përkthyer ky vendim në shqip,
24 si dhe morët Aktakuzën e Konfirmuar.

25 Tani do të doja të dija prej Mbrojtjes nëse kanë

1 parashtrime lidhur me këtë pikë të paraburgimit dhe besoj se
2 ju, z. Avokat, thatë që keni diçka për të thënë në lidhje me
3 paraburgimin. Kështu që fjala është për ju.

4 Z. MARTENS: [Përkthim] Faleminderit. Dhe do dëshiroja të
5 thoja diçka lidhur me këtë.

6 Po. Klienti im është privuar nga liria dhe kjo është e
7 përcaktuar në ligj në nenin 41, askush nuk duhet privuar nga
8 liria përveçse rrethanat e legjitimojnë këtë, e përligjin këtë
9 gjë.

10 Unë e kundërshtoj ligjshmërinë e arrestimit dhe
11 paraburgimit të klientit tim, sidoqoftë, unë dua të flas më
12 konkretisht për arsyet për paraburgim.

13 Pikësëpari, kam diçka për të thënë, ne e kuptojmë, po nuk
14 e dimë saktësisht dhe, mbase ZPS-ja mund të na ndihmojë, në të
15 njëjtën lëndë gjyqësore është edhe një person që nuk është në
16 paraburgim dhe që është ftuar të paraqitet vetë me vullnetin e
17 tij të lirë përpara këtij Trupi Gjykses, pyetja ime është: Pse
18 nuk mund të ndodhte e njëjta gjë për klientin tim?

19 Flasim për arsyet. Rreziku i arratisjes. Është
20 informacion publik dhe mund ta gjeni dhe në media këtë
21 informacion, që klienti im ka qenë objekt i një kërkimi më 30
22 shtator përpara një viti, më shumë se përpara një viti. Në atë
23 kohë, i janë sekuestruar disa sende, është kontrolluar shtëpia
24 e tij, automjeti i tij, por nuk u arrestua në ato momente.
25 Mesa duket, nuk u gjykua e domosdoshme të arrestohej në atë

1 moment.

2 Nga ky moment e në vijim, mesa kuptoj unë nga klienti im,
3 kjo çështje nuk është mbyllur sepse shumë prej sendeve që i
4 janë sekuestruar dhe janë kontrolluar nuk i janë kthyer më
5 klientit tim. Pra, klienti e dinte shprehimisht se çfarë po
6 ndodhte në këto momente dhe se çështja e tij ishte ende në
7 vazhdim e sipër nga ZPS-ja. Dhe e dinim që kjo ishte një
8 çështje që do gjykohej nga Dhomat e Specializuara sepse ZPS-ja
9 ishte institucioni që bëri kontrollin në shtëpinë e tij.

10 Kjo është relevante për arsyen që ju shprehët se ekziston
11 rreziku arratisjes. Pra, u bë kërkimi në shtëpinë e tij
12 përpara një viti. Klienti nuk u largua nga vendi i tij dhe
13 vazhdoi me jetën e tij si çdo ditë.

14 Flasim tani për arsyen e pengimit të drejtësisë. Siç mund
15 ta shohim në aktakuzë, mesa duket këtu flitet për disa raste
16 të izoluar që po ashtu i takojnë verës së 2023 dhe vjeshtës
17 së 2023. Unë nuk kam parë në dokument ndonjë rast tjetër të
18 kryer në periudhën e mëpasshme. Pra, në fakt, nuk arsye që të
19 na le ne të dyshojmë se klienti do të vijojë të kryejë veprat
20 penale për të cilat dyshohet aktualisht.

21 Kjo është relevante për faktin se nëse klienti do ta
22 pengonte drejtësinë. Ai nuk e ka bërë, pse do të duhet të
23 vazhdojë ta bëjë diçka të tillë?

24 Gjithashtu bazuar në dokumentet që na janë dhënë nuk ka
25 asnjë informacion që klienti im të ketë shkatërruar ndonjë

1 provë dhe, sikurse ju thashë, nuk ka rrezik që të përsërisë
2 vepra penale për të cilat akuzohet.

3 Periudha e gjatë që ka kaluar nga fakti që dyshohet që ka
4 ndodhur, nga ngjarja që dyshohet se ka ndodhur e deri tani,
5 tregon në fakt që krimet nuk janë përsëritur dhe nuk ka asnjë
6 arsye për të dyshuar se do të përsëriten në të ardhmen.

7 Sikurse ju thashë, ZPS-ja nuk e gjykoj të nevojshme të
8 arrestonte menjëherë apo më herët dhe kështu Mbrojtja gjykon
9 që klienti im nuk ka shkatërruar asnjë provë edhe nëse shohim
10 dokumentin gjyqësor, shohim që kjo nuk përmendet në asnjë
11 dokument.

12 Krimet, natyra e rëndë e krimeve edhe kushtet në të cilat
13 jeton dhe mjedisi në të cilin jeton tregojnë se klienti do të
14 kryente sërish një krim sipas ZPS-së. Mbrojtja shprehet se nuk
15 ka asnjë arsye për të dalë në këtë përfundim.

16 Pikësëpari, nuk po flasim për vepra të rënda penale për
17 të cilat është ngritur kjo Gjykatë fillimisht. Rrethanat sesi
18 janë kryer krimet e pretenduara, janë diçka për të cilën
19 aktualisht nuk kemi komente ose nuk e kemi të plotë dosjen
20 gjyqësore lidhur me faktet. Sidoqoftë do doja të bëja disa
21 komente sa i takon proporcionalitetit dhe rrethanat personale
22 të klientit tim.

23 ZPS-ja i njeh shumë mirë rrethanat personale të klientit
24 tim si është kërkuar shtëpia, është bërë kërkim në shtëpinë dhe
25 në automjetin e tij përpara një viti. Siç tha klienti, është

1 një profesor i nderuar në Universitetin e Prishtinës, ku punon
2 me kohë të pjesshme. Ka një adresë që nuk e mban të fshehtë.
3 Ka jetuar për një kohë të gjatë në Prishtinë. Qysh prej
4 kërkimit që është bërë përpara një viti, ka qëndruar në
5 adresën e tij. Nuk ka udhëtuar. Ka bërë udhëtimet e zakonshme,
6 kuptohet. Po nuk ka ndryshuar adresën, nuk ka bërë asnjë
7 ndryshim në jetën e tij. Është babi i katër fëmijëve. Tre prej
8 fëmijëve jetojnë ende në shtëpinë e tij dhe janë fëmijë të
9 vegjël, 17, 11 dhe 8 vjeç. Edhe bashkëshortja punon, punon me
10 kohë të plotë dhe për rrjedhojë klienti im është dhe personi
11 që kujdeset për fëmijët më të vegjël në moshë. Kjo është e
12 rëndësishme sepse nuk kanë askënd që të kujdeset për fëmijët
13 aktualisht. Është arrestuar në mënyrë të beftë, pa e ditur
14 dhe kjo është e pajustificuar pse nuk është ftuar dhe klienti
15 im të paraqitej vullnetarisht në këtë lëndë gjyqësore. Ky
16 është të paktën mendimi i Mbrojtjes. Dhe fëmijët kanë ngelur
17 pa babain që të kujdeset për ta ndërkohë që bashkëshortja
18 duhet të punojë në mënyrë që të mbulojë shpenzimet financiare
19 të familjes.

20 Nuk kanë asnjë të afërt që t'i ndihmojë. Gjyshërit nuk
21 jetojnë më. Jeton vetëm babai i klientit, siç më tha klienti,
22 por babi është rreth 80 vjeç dhe për shkak të moshës së thyer
23 dhe të distancës ku jeton, është gati një orë larg banesës së
24 klientit tim, babai nuk mund të kujdeset për fëmijët.

25 Gjithashtu është edhe interesi financiar sepse klienti im

1 punon në mënyrë që të kujdeset për familjen dhe për shpenzimet
2 e familjes.

3 Dhe kjo është një arsye e vlefshme për rrethanat
4 personale të klientit tim që duhet marrë parasysh dhe Mbrojtja
5 kërkon lirimin e klientit. Nuk është e nevojshme ta mbani
6 klientin në paraburgim.

7 Gjithashtu kemi dhe një kërkesë lidhur me lirimin me
8 kusht sipas nenit 41(12) të Ligjit. Klienti im është i gatshëm
9 të ofrojë një vlerë prej 5000 eurosh si garanci, të dorëzoj
10 pasaportën e tij në Kosovë, t'i raportojë EULEX-it sipas
11 rregullave që keni ju, siç ta gjykojë Gjykatësja dhe të
12 plotësojë të gjitha kushtet e tjera që do të caktonte Gjykata
13 nëse do të merrej parasysh kjo kërkesë. Pra, kërkojmë lirimin
14 me kusht nga ana e Mbrojtjes.

15 Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

16 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, Avokati
17 Martens.

18 Prokuroria.

19 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit.

20 Disa pika të shkurtra. Këto që tha Avokati nuk e
21 ndryshojnë qëndrimin tonë dhe vendimin tuaj e nderuar
22 Gjykatëse, vendimi juaj tashmë është marrë sa i takon
23 arrestimit edhe paraburgimit, por dua të trajtojë disa nga
24 aspektet që ngriti Avokati që të jetë dhe pjesa jonë e
25 pasqyruar në transkript.

1 Jemi në një situatë krejt të ndryshme tashmë. Tashmë janë
2 ngritur akuzat dhe janë konfirmuar kundër z. Smakaj dhe kjo
3 është situatë e ndryshme krahasuar me situatën që përmendi
4 Avokati kur u bë kërkimi dhe sekuestrimi. Jemi në një fazë
5 krejt të ndryshme dhe tashmë. Z. Smakaj i njeh akuzat dhe
6 asokohe nuk i njihte dhe përballlet me akuza të rënda dhe mund
7 të kaloj disa vite në burgim nëse shpallet fajtor, kjo
8 ndryshon përllogaritjen apo ndryshon vlerësimin - më falni -
9 për rrezikun e arratisjes.

10 Do t'i përgjigjem tani edhe akuzave që janë ngritur
11 kundër z. Smakaj, konkretisht tentativa për pengimin e
12 drejtësisë që në fakt është vepra kryesore penale në lëndën
13 gjyqësore në fjalë dhe natyra e rëndë e akuzave, që në fakt
14 lidhet dhe me transkript faktorët e tjerë.

15 Z. Smakaj, akuzohet, siç është thënë tashmë, akuzohet për
16 një fushatë në mënyrë të përsëritur për të penguar procesin
17 gjyqësor të kësaj Gjykate. Dhe një pjesë e arsyeve pse jemi
18 sot këtu, pikërisht sot, është për shkak të klimës së
19 ndërhyrjes dhe frikësimit e dëshmitarëve në Kosovë. Kjo është
20 arsyeja kryesore pse jemi këtu. Pra, tentativa për pengimin e
21 drejtësisë në Lëndën 06 dhe të dëshmitarëve të ndryshëm dhe
22 vizitat e ndryshme që ka bërë z. Smakaj me z. Thaçi për
23 qëllimin në fjalë, më konkretisht për të ndërhyrë me një ose
24 më shumë dëshmitarë, është argumenti ynë i fortë dhe ne
25 mendojmë që kjo është në fakt e rëndësishme sepse ne duhet të

1 mbrojmë këtë gjykatë dhe ligjin.

2 Sa i përket aftësisë dhe mundësisë se ai mund të pengojë
3 këtë lëndë gjyqësore po lëndë të tjera gjyqësore, unë mendoj
4 se z. Smakaj ka demonstruar tashmë gatishmërinë dhe vullnetin
5 e tij për ta bërë këtë gjë dhe probabilitetin që do të
6 ndërhyjë edhe më shumë tashmë që është i përballur me akuzat.

7 Pra, për të gjitha arsye që përmenda dhe arsyet që keni
8 vlerësuar ju në vendimin tuaj, ne gjykojmë që paraburgimi i z.
9 Smakaj është i domosdoshëm në këtë lëndë gjyqësore, në bazë të
10 rregullës 41(6).

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

12 Ka diçka për të shtuar më tej Mbrojtja?

13 Z. MARTENS: [Përkthim] Do t'i përgjigjem vetëm faktit që
14 Prokurori i Specializuar nuk e trajtoi siç duhet komentet që
15 bëra unë sa i takon arratisjes. Ai foli për natyrën e rëndë të
16 veprave penale dhe probabilitetit që ekziston që z. Smakaj
17 mund të pengojë drejtësinë edhe të ndikojë tek dëshmitarët apo
18 të prishë provat, po sidoqoftë nuk e trajtoi siç duhet
19 rrezikun e arratisjes. Unë i qëndroj asaj që thashë pak më
20 herët.

21 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit. Do të
22 nxjerr vendim pas një pushimi të shkurtër që do të bëjmë dhe
23 më pas do të mbyllim seancën e sotshme.

24 Aktualisht do t'i kërkoja palëve të shprehen nëse kanë
25 diçka që lidhet ekskluzivisht me seancën e sotme të cilën duam

1 ta trajtojmë tani?

2 Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë.

3 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Avokati Martens.

4 Z. MARTENS: [Përkthim] Nuk kemi asgjë aktualisht.

5 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Nëse nuk ka
6 asnjë për të thënë aktualisht, ora është 11.30. Do bëjmë
7 gjysëm ore pushim.

8 --- Pauza fillon në orën 11.29

9 --- Seanca rifillon në orën 12.02

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani po
11 rifillojmë seancën. Për procesverbal them që palët gjithashtu
12 edhe përfaqësimi i Zyrës Administrative janë këtu, pra të
13 pranishmit nga Zyra Administrative janë në sallën e gjyqit.

14 Tani do nxjerr urdhrin me gojë që ka të bëjë me
15 paraburgimin e z. Smakaj.

16 Avokat Martens, kam mbajtur parasysh kërkesën tuaj për
17 lirim të z. Smakaj me kusht. Po ashtu kam mbajtur shënim
18 parashtrimet tuaja sa i takon mungesës së rrezikut të
19 arratisjes, pasi ju parashtruat që z. Smakaj i është
20 nënshtruar një kontrolli një vit më përpara dhe nuk është
21 arratisur.

22 Po ashtu ju parashtruat që nuk ekziston rreziku i
23 pengimit të proceseve gjyqësore pasi incidentet janë të
24 izoluar, pra incidente të cilat kanë të bëjnë me akuzën,
25 akuzat në fjalë dhe që nuk ekziston rreziku që z. Smakaj të

1 vazhdojë me pengimin e drejtësisë. Për më tepër koha e kaluar
2 nga faktet e pretenduara dhe deri më sot nuk e justifikojnë
3 pengimin e procedurave.

4 Ju gjithashtu parashtruat që nuk ekziston rreziku i
5 kryerjes të krimeve të tjera, duke marrë parasysh rrethanat në
6 të cilat jeton z. Smakaj dhe gjithashtu edhe mjedisin e tij
7 përkatës.

8 Kam marrë gjithashtu parasysh edhe parashtrimet që kanë
9 të bëjnë me propocionalitetin dhe kushtet konkrete të z.
10 Smakaj, domethënë situatën e tij profesionale edhe situatën e
11 tij personale në veçanti.

12 Mbjaj parasysh gjithashtu edhe atë çfarë u parashtrua nga
13 Prokurori që z. Smakaj duhet të vazhdojë që të mbahet në
14 paraburgim sepse janë përmbushur të gjitha kërkesat e
15 parashikuara në kuadrin ligjor përkatës të ZPS-së.

16 Po ashtu vërej që ZPS-ja parashtrroi që tani që janë
17 konfirmuar akuzat, rreziku i arratisjes është më i lartë sesa
18 ç'ka qenë një vit më përpara.

19 Po ashtu kam marrë parasysh parashtrimet e ZPS-së që
20 akuzat me të cilat akuzohet z. Smakaj, janë të rënda në natyrë
21 dhe demonstrojnë gatishmërinë e tij për të ndërhyrë me
22 drejtësinë.

23 Pasi kam shqyrtuar të gjitha argumentet, unë konstatoj se
24 asnjë prej argumenteve të ngritura prej jush, Avokat Mbrojtës,
25 nuk çojnë në ndryshimin e vlerësimit tim, që kushtet e

1 parashikuara në nenin 41 janë përmbushur ashtu siç caktohet në
2 vendimin për fletë-arrestimin, gjithashtu dhe çështje lidhur
3 me to, në paragrafin 46 dhe 69 të 218. Po ashtu nuk jam bindur
4 që z. Smakaj nuk është në rrezik për arratisje, në veçanti për
5 shkak të faktit që, që prej kontrollit në shtator të vitit
6 2023, akuzat e ngritura kundër tij janë konfirmuar, të cilat
7 të mara së bashku me ashpërsinë e veprave penale dhe mundësinë
8 e dënimit përbëjnë një motiv të shtuar për të për t'u
9 arratisur. Po ashtu kam shqyrtuar rrethanat familjare të z.
10 Smakaj dhe në vlerësimin tim, rrethanat familjare të z. Smakaj
11 në Kosovë nuk e ulin rrezikun e tij për t'u arratisur.

12 Sa i takon rrezikut të pengimit të kryerjes së veprave të
13 tjera, unë konstatoj që natyra e izoluar e pretenduar e
14 veprave penale dhe kalimi i kohës janë faktorë të
15 pamjaftueshëm për të ndryshuar konstatimet e mia të bëra në
16 vendimin për fletë-arrestimin dhe çështje lidhur me to, në
17 paragrafin 74 dhe 79.

18 Për pasojë, pasi kam shqyrtuar parashtrimet e palëve, unë
19 vendos që z. Smakaj duhet që të mbetet në paraburgim.

20 Arsyet për ndalimin e z. Smakaj janë të njëjta sikurse
21 janë parashtruar në të njëjtin vendim, në paragrafët 43 dhe
22 69, paragrafi dy.

23 Për pasojë, mbështetur në informacionin edhe materialin
24 që qëndron në bazë të këtij vendime, dhe mungesën e
25 informacionit kontradiktor ndërhyrës ose zhvillimeve të tjera,

1 unë konstatoj së pari, ka dyshim të bazuar mirë sa i takon
2 përgjegjësisë penale për veprat penale të cilat ju lexuan sot.
3 Së dyti, ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ju mund të
4 përbëni rrezik për arratisjes dhe për pengim të procesit
5 gjyqësor.

6 Për më tepër, asnjë prej kushteve të propozuara prej jush
7 dhe asnjë prej kushteve që unë mund të vendos për z. Smakaj,
8 nuk janë të afta që të lehtësojnë këto rreziqe ose që t'i
9 trajtojnë ato siç duhet.

10 Z. Smakaj, unë do rishikoj arsyet për paraburgimin tuaj
11 brenda dy muajsh ose në një kohë më të herët, ashtu siç
12 parashikohet në nenin 41(10) i Ligjit edhe rregullin 57(2) i
13 Rregullores.

14 Avokat Martens, në qoftë se dëshironi që të bëni
15 parashtrime në rishikimin e radhës së paraburgimit, ju lutem,
16 duhet që këto parashtrime t'i dorëzoni deri në mërkurën, datë
17 15 janar 2025. Ndërkohë përgjigjet dhe kundërpërgjigjet do të
18 bëhen sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të
19 Rregullës.

20 Në qoftë se Mbrojtja vendos që të mos dorëzojë
21 parashtrime në afatet e paracekura, unë urdhëroj Zyrën e
22 Prokurorit të Specializuar që të dorëzojë parashtrime për
23 rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Smakaj, jo më vonë
24 sesa të martën, datë 21 janar 2025.

25 Në qoftë se vendos që të përgjigjet, Mbrojtja duhet të

1 përgjigjet jo më vonë sesa të martën, data 28 janar 2025.

2 Unë nuk do të jap kundërpërgjigje.

3 Së fundi, z. Smakaj, ju keni të drejtë që të kundërshtoni
4 dhe të apeloni vendimin e ditës së sotme sa i takon
5 paraburgimit tuaj drejtpërsëdrejti përpara Gjykatës së Apelit
6 brenda 10 ditësh, sikurse parashikohet në nenin 45(2) të
7 Ligjit dhe rregulloren 57 [Sipas përkthimit] e 170 të
8 Rregullores.

9 Kjo përfundon urdhrin gojor timin.

10 Edhe gjithashtu këtu kemi mbërritur në fundin e
11 Paraqitjes së Parë të z. Smakaj. Falënderoj palët për
12 pjesëmarrjen, Zyrën Administrative përkthyesit, stenografët,
13 stafin audioviziv dhe stafin e sigurisë.

14 Këtu mbyllet seanca.

15 --- Seanca e paraqitjes së parë mbyllet në orën

16 12.09

17

18

19

20

21

22

23

24

25